



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Gramsh më 09 /10 / 2023

Shtojca 13

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 09.10.2023

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomik :

- "VËLLEZËRIT HYSA" Sh.p.k me adresë : Elbasan , Klos,Banjë ,fshati Banjë e Re, bashkia Cërrik,pasuria nr.31/50 ,ZK 1093

- "PERPARIMI/G" “ Sh.p.k , me adresë : Gramsh, lagjia "Sporti",pallati 8/ 287 -2 ,kati përdhe .

krijuar me akt-marrëveshjen datë 30.08.2023 dhe përfaqësuar nga "PERPARIMI/G" “ Sh.p.k me NIPT J66702835G

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e Hapur e Thjeshtuar
Numri i procedurës / referenca e Lotit: REF-77316-08-11-2023

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: "Ndërtim i urës tip Bailey, Përroi i Çumes (Dushit), në rrugën automobilistike Kuratë-Grabovë, NJA Lenie"

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike : Buletini Nr. 70 datë 21.08.2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. OE " COLOMBO" Sh.p.k

J82916489E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 8 796 992 (tetë milion e shtatëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë, pa TVSH

2. BOE - "VËLLEZËRIT HYSA" Sh.p.k & "PERPARIMI/G" Sh.p.k K12911201C & J66702835G

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 10 563 351,96 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE " COLOMBO" Sh.p.k

J82916489E

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

për arsyet e mëposhtme:

- Subjekti "Britania" shpk, mbi kapacitetin e të cilit do të mbështetet operatori ekonomik ofertues "Colombo" shpk, në shtojcën 8 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", tek pjesa I/A" ka deklaruar "BRITANIA" shpk & "BRITANIA" shpk – Në rolin e ofertuesit, ndërrohet që nuk është ofertues por subjekt kapacitet mbështetës,
- Në pikën 2.3.5 të kriterëve të vecanta të kualifikimit është kërkuar "Operatori ekonomik/ofertuesi pjesëmarrës në tender së bashku me dorëzimin e preventivit duhet të dorëzojë analizat teknike për të gjithë zërat e punimeve në preventivin të ofertës. (Referuar VKM Nr.514, datë 15.8.2007 "Per informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve në ndërtim". Operatori ekonomik ofertues "Colombo" shpk, ka përlllogaritur pagë orare për të gjithë zërat e preventivit e cila është nën minimumin ligjor të lejuar. Kështu, në analizat teknike të çmimeve të paraqitura, rezulton se paga orare për një pjesë të zërave të punës që parashikon preventivi i procedurës objekt prokurimi janë përlllogaritur me 125 lekë/op dhe për një pjesë të zërave 185 lekë/op. Në nenin 111 të K Punes përcaktohet;...PAGA MINIMALE ."Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave". Në VKM nr.113 datë 01.03.2023 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", përcaktohet shprehimisht: "1. Paga bazë minimale mujore për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 40 000 (dyzetë mijë) lekë. 3. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë. Paga bazë minimale orare referuar VKM –së së mësipërme sa më sipër duhet të jetë 229,9 lekë/orë. Pra, duke qenë se paga orare minimale duhet të jetë 229,9 lekë, llogaritjet e bëra në analizat e paraqitura për pagën orare në masën 125 lekë dhe 185 lekë, bien në kundërshtim me VKM nr.113 datë 01.03.2023.

Në nenin 3/3 të LPP parashikohet se “ Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në nenin 76/pika 3/a të LPP , parashikohet se “ Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:

a) autoriteti ose enti kontraktor provon se ka shkelje të detyrimeve të zbatueshme që lidhen me legjislacionin për mbrojtjen nga diskriminimi, legjislacionin mjedisor, social, të punës, në fuqi apo me marrëveshjet kolektive dhe aktet e së drejtës ndërkombëtare në lidhje me këto fusha, ku Republika e Shqipërisë është palë;

Sa më sipër Operatori ekonomik “Colombo” shpk . ka përgatitur ofertën e tij në kundërshtim me legjislacionin që mbulon fushën e punës, Kodin e Punës dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE - "VËLLEZËRIT HYSA" Sh.p.k me adresë : Elbasan , Klos,Banjë ,fshati Banjë e Re, bashkia Cërrik,pasuria nr.31/50 ,ZK 1093 & "PERPARIMI/G" “ Sh.p.k , me adresë : Gramsh, lagjia "Sporti",pallati 8/ 287 -2 ,kati përdhe, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej 10 563 351,96 (dhjetë milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e treqind e pesëdhjetë e një presje nëntëdhjetë e gjashtë) lekë, pa TVSH / totali i pikëve të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [Bashkia Gramsh,Sheshi kamber Dermyshe, BLV 10 Korriku, kati i tretë i godinës, Personi Përgjegjës për Prokurimet] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)_____

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO

JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë) _____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
KRYETARI I BASHKISË
BESION AJAZI